



Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, bazuar në **Nenin 27, 29 dhe 38** të Ligjit për Ndërtimin Nr. 04/L-110 dt 31.05.2012, me qëllim të realizimit të mbikëqyrjes inspektuese dhe kontrollit teknik për objektet e ndërtuara, publikon këtë:

Ftesë Publike

për shprehje interesi për përfshirje në listën e ekspertëve për mbikëqyrje inspektuese dhe kontrollim teknik

Ftohen të gjithë të interesuarit që të paraqesin kërkesat për përfshirje në listën e inxhinierëve të kualifikuar për ofrimin e shërbimit profesional për realizimin e të mbikëqyrjes inspektuese dhe kontrollit teknik të ndërtimeve të kategorisë së I dhe II, të pajisura me Leje ndërtimi nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Mbikëqyrja inspektuese realizohet sipas Udhëzimit Administrativ nr. 18/2013 Për standardet minimale dhe procedurat për mbikëqyrjen inspektive dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Mbikëqyrje inspektuese nënkupton inspektimin e punëve ndërtimore për të verifikuar pjtueshmërin me dokumentet ndërtimore dhe me Kodin. Mbikëqyrja inspektuese përfshin kontrollin periodik të ndërtimeve sipas Udhëzimit Administrativ nr. 18/2013, dhe nënshkrimin e protokolleve.

Kontrolli teknik realizohet në bazë të nenit 49, 50 dhe 51 të Ligjit për Ndërtim 2004/15 dt 14.10.2004, duke u mbështetur në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të nenit 38 të Ligjit për Ndërtimin Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, Udhëzimit Administrativ nr. 68/2005.

I. Të drejtë për të marrë pjesë në këtë ftesë publike kanë të gjithë personat fizik të cilët i plotësojnë kushtet si në vijim:

a) Dëshmi se janë qytetarë të Republikës së Kosovës;

b) Dëshmi për kualifikimin profesional

1. Në Inxhinieri -Inxhinier i diplomuar,(5 vjeçar) ose shkallë më të lartë e kualifikimit si:
 - a. Inxhinier i Arkitekturës;
 - b. Inxhinier i Ndërtimtarisë, Drejtimi Konstruktiv;
 - c. Inxhinier i Ndërtimtarisë, Drejtimi i Hidroteknikës;
 - d. Inxhinier i Makinerisë, Drejtimi Termoteknikë dhe Termoenergjetike;
 - e. Inxhinier i Elektroteknikës, Drejtimi Elektro-Energjetik;
2. Në Lëmin e mbrojtjes nga zjarri- Inxhinier i mbrojtjes ose Provim profesional për mbrojtje nga zjarri
3. Në çështje juridike- Jurist i diplomuar (4 vjeçar) ose kualifikim më i lartë

c) dëshmi për 5 vite përvojë pune në lëmin e ndërtimit, projektimit, mbikëqyrjes së ndërtimeve.

II. Së bashku me dëshmitë e cekura në pikën I, të interesuarit duhet të dorëzojnë CV dhe referencat të cilat dëshmojnë për punët e kryera;

III. Kërkesat sipas Shtojcës 1. së bashku me dokumentacionin e kërkuar pranohen përgjatë vitit duke filluar nga data e publikimit në media. Dokumentacioni i kompletuar dërgohet në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërtesa e re e Komunës, „Arbëri 3", kati 3.


IV . Kërkesat e pakompletuara nuk do të merren parasysh .

V. Kërkesat shqyrtohen nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, lista do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Prishtinës.

VI . Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet do të njoftohen me shkrim përmes e-mailit për nënshkrimin e kontratës dhe për mënyrën e angazhimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina

Kërkesë për Shprehje Interesi

1. Informacionet rreth Kërkuesit			
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Emaili:			

2. Detajet rreth arritjes profesionale	
Shkollimi:	
Titujt (gradat):	
Punimet , publikimet:	

3. Detajet rreth përvojës së punës	
Përvoja e punës (vitet):	
Punimet, Projektet, Mbikëqyrjet:	
Tjera:	

4. Dokumentet e kërkuara (rretho)	
a.	Kopja e dokumentit të identifikimit
b.	CV me Referencat
c.	Diploma/ Certifikata (dëshmi për arritjen profesionale të noterizuar)

Nënshkrimi i kërkuesit	Vendi:
Data (DD/MM/VVVV):	